

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR. 200



KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot, me date 19.01.2005 (dymije e pese) para meje noteres u paraqiten personalisht ;

SHITESI : Z.Jani Myrto, lindur me date 13.03.1954 ne Larisa dhe banues ne Athine me nr. Pas M 891787 ortak i vetem i shoqerise The Blue Star shpk.

BLERESI : Shoqeria FIVE OAKS ENTERPRISES LIMITED me seli ne Lefkosa Rr.Sofuli nr.2 Megano Siandekler kati 8 nr.803, me nr.regjistri tatimor 68554 dt. 06.04.1995 Qipro perfaqesuar me procure, bashkengjitur kesaj kontrata dt.01.11.2004 nga zoti George Karlatiras avokat i Athinmes me nr. Te shoqates se avokateve te Athines me nr. AM 5973 e nr.Pasaporte T 030950.

Shoqeria The Blue Star shpk eshte regjistruar si person juridik me vendimin e gjykates se Rrethit Tirane nr.16708, date 20.01.1997 dhe ka bere ndryshime me vendim te gjyqtarit te vetem me nr.16708/1 dhe 5947 date 02.12.1998, me vendimet nr.16708/2, nr.16708/3, nr.16708/4, nr.16708/5, nr.16708/6, nr.16708/7, dhe i fundit nr.16708/8 date 08.05.2003 kjo shoqeri ka si ortak te saj te vetem z. Jani Simon Myrto dhe kapital i saj eshte 16.000.000 leke me objekt veprimtarie ne fushen e prodhimit te konfeksioneve sipas objektit te percaktuar ne aktet e kesaj shoqerie.

Me vendimin e Asamblese se Ortakeve (ortakut te vetem) z. Jani Somon Myrto date 15.06.2001 ortaku i vetem i shoqerise Jani Simon Myrto ka marre vendim per t'u larguar nga kjo shoqeri duke i shitur kuotat e tij tek shoqeria FIVE OAKS ENTERPRISES LIMITED e cila pranon te bleje kuotat e ketij ortaku te vetem te shoqerise The Blue Star duke u bere ai ortak i vetem i kesaj shoqerie me 100 % te kapitalit. Administrator i shoqerise The Blue Star shpk do te jete z. Andrea Mico.

Z. Jani Simon Myrto shet dhe shoqeria Five Oaks Enterprises Limiter ble 100 % te kapitalit te tij ose 16.000 pjese me nje vlere prej 16.000.000 leke te cilat jane likuiduar ne cash. Vlera e nje pjese eshte 1.000 leke. Qe nga ky moment ortaku i mesiper shites nuk ka me asnje lloj te drejte mbi kete shoqeri dhe ortak i vetem me 100 % te kapitalit behet bleresi shoqeria FIVE OAKS ENTERPRISES LIMITED. Qe nga ky moment bleresi i cili behet dhe ortak i vetem ne kete shoqeri merr persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe ka kjo shoqeri ketej e tutje ndaj shtetit dhe te treteve. Detyrimet deri ne momentin e shitjes se kuotave detyrimet e shoqerise ndaj shtetit dhe ndaj te treteve i ka shitesi. Shoqeria nuk ben ndryshime te tjera te cilat mbeten ashtu sic kane qene.

Kontrata e shitblerjes u redaktua konform nenit 702 e vijues te Kodit Civil si dhe konform nenit 47 te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare" si dhe konform vullnetit te lire dhe te plote te paleve te cilet pasi lexuan permbajtjen e aktit e nenshkruan si me poshte.

Une noteri verifikova identitetin e paleve, ju lexua me ze te larte aktin noterial dhe pasi e gjeta konform vullnetit te tyre e vertetoj si me poshte.

P A L E T

SHITESI
JANI SIMON MYRTO

BLERESI
Shoqeria FIVE OAKS ENTERPRISES LIMITED
Perf. George Karlatiras

NOTER
AFRODITI GJESER